




# HATIXHE BILIBASHI

***Nisi si startup, sot  
sipërmarrëse me përvojë!  
Qendra e parë në Shqipëri në  
fushën ICT për fëmijë***

Hatixhe Bilibashi, një 32-vjeçare nga Tirana, nisi me pasionin e saj për teknologjinë para 10 vitesh me disa iniciativa që ishin modeste për kohën. Ajo është ideatorja e Albanian ICT Academy, që sot është e para qendër e krijuar në Shqipëri në fushën e ICT për fëmijë. Hatixhe kujton se si ideja e saj nisi si një startup, nëpërmjet një bashkëpunimi të ngushtë me RisiAlbania dhe çdo vit që pasoi, si arriti të hedhë hapa të mëdhenj në zhvillimin e mëtijshëm të sipërmarrjes së saj.

Një projekt nga Agjencia Zvicerane për  
Zhvillim dhe Bashkëpunim SDC

 Schweizerische Eidgenossenschaft  
Confédération suisse  
Confederazione Svizzera  
Confederaziun svizra

Agjencia Zvicerane për Zhvillim  
dhe Bashkëpunim SDC

Në partneritet me:



Zbatuar nga:



Në vitin 2018, "Business Strategy" ishte projekti që mori mbështetje maksimale për t'u konsoliduar në vazhdim. Albanian ICT Academy tregoi se pati një zhvillim të qëndrueshëm në tregun shqiptar. Projekti u finalizua me zhvillimin e Strategjisë së Marketingut, Studimin e Tregut të Punës në Fushën e ICT dhe si rezultat i këtij studimi, u zhvilluan kurrikula të reja profesionale në kategorinë "Ready to Work", ku gjithçka u realizua në mënyrë të përsosur sipas kërkesave të tregut të punës.

Projekti i vitit 2019 është "Girls in ICT", i cili synonte trajnimin e vajzave nga grupe të marginalizuara duke ofruar kurse në fushën e ICT dhe mbështetjen e tyre deri në punësim. Nëpërmjet këtij projekti u trajnuan vajza nga Fshati "SOS" dhe nga grupe të tjera në nevojë, në bashkëpunim me Bashkinë e Tiranës ku thuajse 85% e tyre janë punësuar.

Sukses në vazhdimësi të këtij projekti është dhe konsolidimi i Organizatës jo Fitimprurëse "STEM Hub" me synim mbështetjen për punësimin e vajzave dhe grave në fushën e ICT dhe STEM. Projekti i vitit 2024 vjen në kuadër të Ditës Ndërkombëtare të vajzave në ICT: më 26 Prill 2024 u zhvillua "Leadership" Hackathon me pjesëmarrjen e 50 vajzave nga e gjithë Shqipëria dhe mbështetjen e grupeve fituese me trajnime të kategorisë "Ready to Work".



### **Si u vu në dijeni për këto projekte, të cilat sot Hatixhen e shndërruan në një sipërmarrëse me përvojë?**

*"Nga kontaktet e mediave sociale u paraqita në intervistat e zhvilluara nga ekspertë që RisiAlbania kishte ngarkuar për projektin. Duke qenë se para disa vitesh fusha e ICT ishte jo shumë e njohur, qëllimi im ishte mbështetja për ta zhvilluar dhe konsoliduar sipërmarrjen time", tregon Hatixhe. Sipas saj, e gjitha rezultoi me rritje të biznesit, në numrin e të rinjve të trajnuar dhe u arrit krijimi i OJF "STEM Hub".*

Projektet në të cilat Hatixhe mori pjesë në vazhdimësi për disa vite, e ndihmuan në rritjen e kapaciteteve të Albanian ICT Academy, në zhvillimin e kurrikulave inovatore sipas kërkesave që tregu i punës ka, në qëndrueshmërinë e sipërmarrjes në një kohë më të shpejtë. Por, fakti që Albanian ICT Academy ka zhvilluar disa projekte me RisiAlbania tregon një sukses bashkëpunimi të vazhdueshëm, dhe Hatixhe akoma sot thotë:

*"Jam e hapur për çdo projekt dhe partneritet të ri me RisiAlbania. Pritshmëritë e mia u përmbushën dhe u tejkaluan nga këto bashkëpunime".*

Sot, Albanian ICT Academy është një ofrues trajnimi me potencial të lartë në TIK, në bashkëpunim me RisiAlbania ka prezantuar kurse të reja në kërkesë, duke synuar të trajnojë dhe punësojë më shumë studentë në bashkëpunim të ngushtë me punëdhënësit.

Albanian ICT Academy është shndërruar në një frymëzim për ofruesit e tjerë të trajnimeve, për përmirësimin e ofertës së trajnimeve të përshatura për nevojat e grupeve të marginalizuara. Si e para qendër në Shqipëri e këtij lloji, ofron cilësi, profesionalizëm dhe trajnime të avancuara në fushën e TIK për fëmijët, e krijuar për t'u shërbyer nxënësve të moshës shkollore me mundësi për të zhvilluar talentin e tyre në zhvillimin e softuerit dhe robotikës, si dhe për profesionistët sipas modelit "Ready to work".

Albanian ICT Academy në bashkëpunim me RisiAlbania ka forcuar ndërmjetësimin për punësim, përveçse iu jep mundësi të gjithë të apasionuarve të rrisin njohuritë e tyre duke ju vënë në dispozicion sot laboratorë me teknologji inovatore.

